



UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 771/1 , prot.

Tiranë, më 17/ 09/ 2020

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik
Tiranë

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë si më poshtë:

FAKULTETI I ARTIT SKENIK

1, Kr / Sekretare (Sekretetare e Dekanit)

1/1. Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo kandidat, për pozicionin e punës sa më lart në dosjen e tij duhet të ketë:

- Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar vendi për të cilin ai konkurren;
- Diplomë origjinale + fletë notash (shkollë e lartë, mesatare e përgjithshme mbi 8), ose fotokopje e noterizuar, e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MAS&R;
- Jetëshkrim (CV) i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet;
- Të ketë dëshmi njohjes së programeve kompjuterike excel dhe word;
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj, preferuar anglisht;
- Referenca nga punëshënësi i fundit;



- Dokumente që vërtetojnë përvojën në punë (fotokopje të librezës së punës);
- Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
- Çertifikatë familjare;
- Të deklarojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Dëshmi e gjendjes mjekësore.

Kandidati për konkursin duhet të plotësojë këto kritere:

- Kërkesë ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkuron;
- Diplomë origjinale + fletë notash/fotokopje e noterizuar (shkollë e lartë) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
- Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të;
- Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (e preferuar anglisht);
- Të vërtetojë që ka përvojë pune;
- Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
- Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
- Çertifikatë familjare;
- Të deklarojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Dëshmi e gjendjes mjekësore.

Konkurrimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e AL në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Procedurave Administrative, Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar.



Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Universitetin e Arteve nga data **21/09/2020** deri më datë **05/10/2020** ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.

Prof. Kastriot ÇAUSHI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE